# СЛУЖБЕНИ ГЛАСНИК ОПШТИНЕ БУЈАНОВАЦ

# GAZETA ZYRTARE E KOMUNËS SË BUJANOCIT

| ГОДИНА-VITI **III.**<br>БРОЈ-NUMËR **3.** | БУЈАНОВАЦ - BUJANOC<br>Петак 13.03.2015<br>E premte 13.03.2015 | Издаје се по потреби<br>Botohet sipas nevojës<br>Цена – Çmimi 500 din. |
|---|---|---|


**АКТИ ОПШТИНЕ**
**AKTET E KOMUNËS**

**БУЈАНОВАЦ**
**BUJANOC**

**Акти Општинског већа**
**Aktet e Këshillit komunal**

**52**

На основу члана 17. Закона о јавном информисању и медијима („Сл. гласник РС“, бр.83/14), и основу члана 20. и 46. Закона о локалној самоуправи ( „Сл.гласник РС" бр. 129/2007 и 83/2014-др закона) и члана 14. Став 1. тачка 36. Статута општине Бујановац („Сл.гласник пчињског округа" бр.24/08), и на основу правилника о суфинасирању пројеката за остваривање јавног интереса у области јавног информисања („Службени гласник РС”), број 04/2014- од 13 новембар 2014 год., Општинско веће општине Бујановац, на седници одржаној дана **11.03.2015.** god. године, донело је:

Në bazë të nenit 17 të Ligjit mbi informimin publik dhe mediave („Gz.zyrtare e RS’’nr. 83/14) dhe në bazë të nenit 20 dhe 46 të Ligjit mbi vetëadministarën lokale (“Gazeta zyrtare e RS” nr. 129/2007 dhe 83/2014 – ligjeve tjera) dhe nenit 14. Paragrafi 1. pika 36. të Statutit të Komunës së Bujanocit (“Gazeta zyrtare e Rrethit të Pçinjës”, nr. 24/08) dhe në bazë të rregullores mbi bashkëfinancimin e projekteve për realizimin e interesit publik në sferën e informimit publik (“Gazeta zyrtare e RS”, numër 04/2014 e datës 13 nëntor 2014) Këshilli komunal i Komunës së Bujanocit në seancën e mbajtur më **11.03.2015.**, miratoi:

**ПРАВИЛНИК**
**О УСЛОВИМА И НАЧИНУ КОРИШЋЕЊА СРЕДСТАВА ЗА ЈАВНО ИНФОРМИСАЊЕ ОД ЛОКАЛНОГ ЗНАЧАЈА**
**RREGULLORE**
**MBI KUSHTET DHE MËNYRËN E SHFRYTËZIMIT TË MJETEVE PËR INFORMIM PUBLIK TË RËNDËSISË LOKALE**

**I. УВОДНЕ ОДРЕДБЕ**
**I. DISPOZITAT HYRËSE**

**Члан – Neni 1**

Овим Правилником уређују се услови и начин коришћења средстава за јавно информисање грађана од локалног значаја, избор програма и пројеката у области јавног информисања који се суфинансирају из буџета Општине Бујановац, поступак и услови закључења уговора о јавном информисању и друга питања од значаја за реализацију обавезе Општине Бујановац (у даљем тексту:Општина) да обезбеди услове за јавно информисање локалног становништва.

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të mjeteve për informim publik të qytetarëve me rëndësi lokale, zgjedhja e programeve dhe projekteve në sferën e informimit publik të cilat bashkë-financohen nga buxheti i komunës Bujanocit, procedura dhe kushtet e lidhjes së kontratës mbi informimin publik dhe çështjeve tjera me rëndësi për realizimin e obligimit të Komunës Bujanocit (në tekstin në vazhdim: Komuna) të siguroj kushtet për informimin publik të banorëve lokal.

**Члан - Neni 2.**

Општина обезбеђује услове за услуге јавног информисање грађана од локалног значаја улагањем финансијских средстава за програма и пројекте намењене информисању јавности о: заштити и развоју људских права и демократије; унапређивању правне и социјалне државе; слободном развоју личности и заштити деце и младих; развоју културног и уметничког стваралаштва; развоју образовања, укључујући и медијску писменост као део образовног система; развоју науке, спорта и физичке културе; заштити животне средине и здравља људи; унапређивању медијског и новинарског професионализма и осталих медијских садржаја који доприносе задовољавању потреба грађана за информацијама и садржајима из свих области живота, без дискриминације.

Komuna i siguron kushtet për shërbimet e informimit publik të qytetarëve të rëndësis lokale me investimin e mjeteve financiare për programet dhe projekte e dedikuara për: informimin e qytetarëve mbi mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të njeriut dhe demokracisë; përmirësimin e shtetit ligjor dhe social; zhvillimi i lirë të personalitetit dhe mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve; zhvillimi i krijimtarisë kulturore dhe artistike; zhvillimi i arsimit, duke përfshirë njohurive për mediat, si pjesë e sistemit arsimor; zhvillimi i shkencës, edukimit fizik dhe të sportit; mbrojtja e mjedisit dhe shëndetin e njeriut; përmirësimin e mediave dhe profesionalizmi gazetaresk, dhe media të tjera që kontribuojnë në plotësimin e nevojave të shtetasve për informata dhe përmbajtje nga të gjitha sferat e jetës pa diskriminim.

**Члан - Neni 3.**

Средства за финансирање потреба у области јавног информисања се планирају у буџету општине Бујановац за сваку календарску годину.

Mjetet për financimin e nevojave në sferën e informimit publik planifikohen në buxhetin e komunës së Bujanocit për çdo vit kalendarik.

Средства се додељују на основу јавног конкурса.

Mjetet ndahen në bazë të konkursit publik.

## II. КОНКУРС
## II. KONKURSI

**Члан - Neni 4.**

Јавни конкурс за суфинансирање локалних медија којима се обезбеђује јавно информисање грађана од локалног значаја за намене из члана 2 овог Правилника. Оделење за Јавне сужбе и Друштвене делатности општине Бујановац, расписује конкурс и спроводи поступак.

Konkursi publik për bashkëfinancimin e mediave lokale me të cilat sigurohet informimi publik i qytetarëve të rëndësisë lokale për qëllimet nga neni 2 i kësaj Rregullore.Drejtorati për Shërbime publike dhe Veprimtari shoqërore i komunës së Bujanocit, shpall edhe udhëheqë procedurën e konkursit.

Конкурс се расписује два пута годишње.

Konkursi shpallet dy herë në vit.

**Члан - Neni 5.**

Конкурс се расписује за пројекте:

Konkursi shpallet për projektet:

1) производње медијских садржаја;
   prodhimi i përmbajtjeve mediale;
2) организовања и учешћа на стручним, научним и пригодним скуповима, као и унапређивања професионалних и етичких стандарда у области јавног информисања.
   Organizimin dhe pjesëmarrjen në tubimet profesionale, shkencore e përkujtimore si dhe ngritjen profesionale dhe të standardeve etike në fushën e informimit publik;

**Члан - Neni 6.**

Јавни позив за учешће на конкурсу садржи:

Ftesa publike për pjesëmarrje në konkurs përmban:

1) намену средстава за остваривање јавног интереса, тј. јавни интерес који ће се конкурсом суфинансирати;
   qëllimin e fondeve për realizimin e interesit publik, d.m.th. interesi publik i cili me konkurs do të bashkëfinancohet;
2) износ средстава која су опредељена за конкурс;
   shumën e fondeve që është e përkufizuar në konkurs;
3) који субјекти имају право учешћа;
   cilat subjektet kanë të drejtë të marrin pjesë;
4) критеријуме за оцену пројекта на основу којих ће се додељивати средства;
   kriteret për vlerësimin e projektit mbi bazën e të cilit do të ndahen fondet;
5) прецизне рокове у којима се спроводи конкурс;
   afatet e sakta për zbatimin e konkursit;
6) информацију о документацији коју прилаже подносилац пројекта;
   informacion mbi dokumentacionin i cili është dorëzuar nga aplikuesit e projektit;
7) позив новинарским и медијским удружењима као и медијским стручњацима заинтересованим за рад у комисији.

Ftesën për shoqatat e gazetarëve dhe të mediave, si dhe profesionistët e medias të interesuar në punën e komisionit.

Конкурс се објављује на званичној интернет страници општине (вебсајт општине) и у писаним медијима у којима општина објављује јавне позиве.

Konkursi do të publikohet në web faqen zyrtare të komunës dhe në mediat e shkruara në të cilat komuna boton shpalljet publike.

**Члан - Neni 7.**

Проверу документације поднете на конкурс врши Оделење за Јавну службу и Друштвене делатности општине Бујановац

Verifikimin e dokumenteve të paraqitura në konkurs, e kryen Drejtorati për Shërbime publike dhe Veprimtari shoqërore i komunës së Bujanocit.

Провера документације из става 1. овог члана односи се на испуњеност услова за учешће на конкурсу и поштовање рокова.

Verifikimin e dokumentacionit nga paragrafi 1. të këtij neni i referohet plotësimit të kushteve për pjesëmarrje në konkurs dhe respektimi i afateve

**Члан - Neni 8.**

Учесник конкурса који је поднео пројекат са непотпуном или непрецизно попуњеном документацијом, обавештава се да недостатак отклони у накнадно одређеном року.

Pjesëmarrësi i konkursit që ka paraqitur një projekt me dokumentacion jo të plotë ose të pasaktë, do të njoftohen për të korrigjuar mungesën në një kohë të caktuar.

Пројекат учесника конкурса који у накнадно одређеном року не достави тражену документацију, не разматра се.

Pjesëmarrësi i projektit në konkurs të cilët në afatin e caktuar nuk paraqesin dokumentacionin e kërkuar, nuk do të merren në shqyrtim.

Учеснику конкурса који није поднео ниједан прописани документ наведен у јавном позиву за учешће на конкурсу, осим обрасцa за пријаву, не доставља се обавештење из става 1. овог члана и његов пројекат се не разматра.

Pjesëmarrësit të konkursit i cili nuk ka paraqitur asnjë dokument të kërkuar në ftesën publike për pjesëmarrje në konkurs, me përjashtim të ekstraktit për aplikim, nuk i dërgohet njoftimi i referuar nga paragrafi 1. të këtij neni dhe projekti i tij nuk shqyrtohet.

Пројекат који је достављен након прописаног рока за подношење, не разматра се.

Projekti i cili është dorëzuar pas afatit të paraparë për dorëzim, nuk do të shqyrtohet.

Оделење за Јавну службу и Друштвене делатности општине Бујановац сачињава записник о испуњености услова за учешће на конкурсу, за све пристигле пројекте и доставља записник члановима комисије.

Drejtorati për Shërbime publike dhe Veprimtari shoqërore pranë komunës së Bujanocit, përpilon procesverbalin për përmbushjen e kushteve për pjesëmarrje në konkurs, për të gjitha projektet e pranuara dhe procesverbalin ia dorëzon anëtarëve të komisionit.

**Члан - Neni 9.**

На конкурсу може учествовати :

Në konkurs mund të marrin pjesë:

1) издавач медија, чији медиј је уписан у Регистар медија, који се води у Агенцији за привредне регистре;
   botues media, medium i të cilit është regjistruar në Regjistrin për media, e që evidentohet në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit;
2) правно лице, односно предузетник, који се бави производњом медијских садржаја и који има доказ да ће суфинансирани медијски садржај бити реализован путем медија;
   personi juridik, përkatësisht sipërmarrësi, i cili merret me prodhimin e përmbajtjes së mediave dhe ka prova që përmbajta mediale e bashkëfinancuar do të realizohet përmes mediave;
3) правно лице, односно предузетник, са пројектима организовања и учешћа на стручним, научним и пригодним скуповима, као и са пројектима унапређивања професионалних и етичких стандарда у области јавног информисања.
   personi juridik, përkatësisht sipërmarrësi, me projektet e organizuara dhe pjesëmarrja në ngjarje profesionale, shkencore dhe përkujtimore, si dhe projektet për përmirësimin e standardeve profesionale dhe etike në fushën e informimit publik.

Изузетно од става 1. тачка 3) овог члана, не може суфинансирати пројекат издавача медија, који није уписан у Регистар медија, односно Регистар јавних гласила.

Përjashtimisht nga paragrafi 1. pika 3) të këtij neni nuk do të bashkëfinancohet botuesi i projektit të medias, i cili nuk është i regjistruar në Regjistrin e mediave, gjegjësisht Regjistrin e mediave publike.

**Члан - Neni 10.**

Право учешћа на конкурсу немају издавачи медија који се финансирају из јавних прихода.

Të drejtën e pjesëmarrjes në konkurs nuk e kanë botuesit media të financuara nga fondet publike.

Право учешћа на конкурсу немају лица која су у претходном периоду добила средства намењена пројектном суфинансирању, а нису на време и у прописаној форми поднела наративни и финансијски извештај.

Të drejtën e pjesëmarrjes nuk e kanë personat që kishin marrë më parë fonde të destinuara për projekt bashkëfinancimit,që nuk kishin paraqitur në kohën dhe në formën e përcaktuar raportin narrativ dhe atë financiar.

**Члан - Neni 11.**

Учесник конкурса може конкурисати само са једним пројектом на једном конкурсу.

Aplikuesi në konkurs mund të konkurrojë vetëm me një projekt në një konkurs.

Под пројектом се подразумева заокружена програмска целина или део целине (жанровска и временска), којом се доприноси остваривању јавног интереса, у складу са Законом.

Me projekt nënkuptohet përmbledhja e tërësishme e programit apo pjesë të një e tërësie (zhanër dhe në kohë), i cili kontribuon në arritjen e interesit publik, në përputhje me Ligjin.

Ако је учесник конкурса издавач више медија, може на конкурсу учествовати са једним пројектом за сваки медиј.

Nëse aplikuesi në konkurs është publikues i disa mediave, mund të marrë pjesë në konkurs me një projekt për çdo medium.

**Члан - Neni 12.**

Подносиоцима пријаве-Образац, "Пријава на Конкурс суфинансирање програма односно пројекта у области јавног информисања" као и образац понуде доступни су и на званичној интернет страници Општине (www.bujanovac.rs ).

Parashtruesve të aplikacionit -Ekstrakti, "Paraqitja në Konkursin për bashkëfinancimin e programeve, gjegjësisht projekteve në sferën e informimit" si dhe ekstrakti i ofertës gjenden edhe në faqen zyrtare të komunës në internet (www.bujanovac.rs).

Пријаве се подносе у штампаном облику, предајом на Писарници Општинске управе Бујановац или поштом.

Aplikacionet paraqiten në formë të shkruar, duke i dorëzuar në Shkresoren e Administratës komunale në Bujanoc ose me postë.

Рок за подношење пријава на конкурс овог члана не може бити краћи од 20 дана од дана објављивања.

Afati për paraqitjen e aplikacionit në konkurs të këtij neni nuk mund të jetë më i shkurtër se 20 ditë nga dita e publikimit.

**Члан - Neni 13.**

Критеријуми на основу којих ће се оцењивати пројекти пријављени на конкурс су:

Kriteret në bazë të cilave do të vlerësohen projektet e paraqitura në konkurs janë:

1) мера у којој је предложена пројектна активност подобна да оствари јавни интерес у области јавног информисања;
   masa në të cilën aktiviteti i projektit është propozuar, është e volitshme për të realizuar interesin publik në fushën e informimit publik;

2) мера пружања веће гаранције привржености професионалним и етичким медијским стандардима.
   masat për të siguruar garanci më të mëdha në respektimin e standardeve profesionale dhe etike të medias.

На основу критеријума из става 1. тачка 1) овог члана, посебно се оцењује:

Në bazë të kritereve të përmendura në paragrafin 1. pika 1) të këtij neni, në veçanti vlerësohet:

1) у којој мери су предложена пројектна активност и изложени циљеви њене реализације релевантни за остваривање намене конкурса;
   masa në të cilën aktiviteti i propozuar i projektit dhe objektivat e zbatimit të tij janë të rëndësishme për arritjen e qëllimeve të konkursit;
2) у којој мери је вероватно да ће предложене пројектне активности довести до остваривања постављеног циља (могу се утврдити на основу начина на који је објашњена веза између активности и циљева, прецизности индикатора успеха, квалитета предложеног метода евалуације, претходног искуства кључних чланова пројектног тима и других чинилаца које може да одреди орган који расписује конкурс);
   masa në të cilën ka gjasa që aktivitetet e propozuara të projektit të çojë në arritjen e qëllimit të caktuar (mund të vërtetohet në bazë të mënyrës së shpjegimit të lidhjes mes aktiviteteve dhe objektivave, saktësinë e treguesve të performancës, cilësisë së

indikatorëve të suksesit, kualitetit të metodës së propozuar të evoluimit, përvojën e mëparshme të anëtarëve kyç të ekipit të projektit dhe faktorë të tjerë që mund të përcaktojë organi që shpallë konkursin);

3) у којој мери однос између предложених трошкова и очекиваних резултата указује да би коришћењем буџетских средстава на најрационалнији начин био остварен јавни интерес.
masa në të cilën marrëdhëniet midis kostove të propozuara dhe rezultateve të pritura tregojnë se përdorimi i fondeve buxhetore në mënyrën më racionale është realizuar interesi publik.

На основу критеријума из става 1. тачка 2) овог члана посебно се оцењује:

Në bazë të kritereve të përmendura në paragrafin 1. pika 2) të këtij neni do të shqyrtohet veçmas:

(1) да ли су учеснику конкурса изречене мере од стране државних органа, регулаторних тела или тела саморегулације у последњих годину дана, због кршења професионалних и етичких стандарда;
nëse pjesëmarrësit në konkurs ju kanë caktuar masa nga organet shtetërore, organet rregullatorë apo organeve të vetë-rregullimit në vitin e kaluar për shkak të shkeljes së standardeve profesionale dhe etike;

(2) доказ о томе да су након изрицања казни или мера предузете активности које гарантују да се сличан случај неће поновити;
dëshmi se pas shqiptimit të dënimeve ose masave janë ndërmarrë aktivitete të cilat garantojnë se një rast i ngjashëm nuk do të përsëritet;

За сваки расписани конкурс, у оквиру јавног позива, орган који расписује конкурс може утврдити и специфичне ближе критеријуме за оцењивање пројекта.

Për çdo konkurs të shpallur, në kuadër të shpalljes publike, organi që shpall konkurs mund të vendosë kritere specifike dhe të detajuara për vlerësimin e projektit.

## III. СРЕДСТВА ЗА СУФИНАНСИРАЊЕ
## III. MJETET PËR BASHKËFINANCIM

**Члан - Neni 14.**

Од укупно опредељених средстава за конкурс, најмање 90% износа средстава мора бити намењен пројектима производње медијских садржаја, а највише 10% износа средстава може бити намењен пројектима организовања и учешћа на стручним, научним и пригодним скуповима као и пројектима унапређивања професионалних и етичких стандарда у области јавног информисања.

Prej mjeteve të përgjithshme të orientuara për konkurs, së paku 90% e shumës patjetër duhet t'i destinohet projekteve të prodhimit të përmbajtjeve mediale, ndërkaq më së shumti 10% e shumës së mjeteve mund të destinohet projekteve për organizimin e pjesëmarrjes në tubimet profesionale, shkencore dhe tubimeve të rastit si dhe për projektet e përprarimit profesional dhe të standardeve etike në sferën e informimit publik.

Проценат опредељених средстава за намене из става 1. овог члана, утврђује орган који расписује конкурс, одлуком којом се расписује конкурс.

Përqindjen e mjeteve të orientuara për destinimin nga parag. 1. të këtij neni, e përcakton organi i cili e shpallë konkursin, me vendimin me të cilin shpallet konkursi.

**Члан - Neni 15.**

Учесник конкурса може поднети захтев за суфинансирање пројекта у износу до највише 80% вредности предложеног пројекта, односно највише до износа утврђеног конкурсом.

Pjesëmarrësi i konkursit mund të paraqese aplikacion për bashkëfinancim të projektit në shumë deri në 80% të vlerës së projektit të propozuar, gjegjësisht më së shumti deri në shumën e përcaktuar me konkurs.

**Члан - Neni 16.**

Учесник конкурса коме су додељена средства за пројекат може у току исте календарске године да учествује и на другом конкурсу за суфинансирање, са истим пројектом, с тим да укупно додељена средства не прелазе 80% вредности пројекта.

Pjesëmarrësi i konkursit të cilit i janë ndarë mjetet për projektin ka mundësi që gjatë të njëjtit vit kalendarik të merrë pjesë edhe në konkursin e dytë për bashkëfinancim, me të njëjtin projekt, me atë që mjetet e përgjithshme të ndara të mos kalojnë 80%-shin e vlerës së projektit.

## IV. ПОСТУПАК ДОДЕЛЕ СРЕДСТАВА
## IV. PROCEDURA E NDARJES SË MJETEVE

**Члан - Neni 17.**

Оцену пројеката поднетих на конкурс, као и предлог о додели средстава са образложењем, доноси стручна комисија (у даљем тексту: комисија) коју решењем именује општинско веће.

Vlerësimi i projekteve të paraqitura në konkurs, si dhe propozimi për ndarjen e fondeve, me arsyetim, e miraton Komisioni profesional (në tekstin

e mëtejmë Komisioni), i emëruar me aktvendim të këshillit komunal.

Комисија се именује за сваки конкурс.
Komisioni emërohet për çdo konkurs.

**Члан - Neni 18.**

За члана комисије именује се лице које је независни стручњак за медије или је медијски радник.

Për anëtarë të Komisionit do të emërohet personi i cili është një ekspert i pavarur për media apo punëtor mediatik.

Предложена лица не смеју бити у сукобу интереса нити обављати јавну функцију, у складу са правилима о борби против корупције.

Personat e propozuar nuk duhet të jenë në konflikt interesi apo të kryejnë detyra publike, në përputhje me rregullat e luftës kundër korrupsionit.

**Члан - Neni 19.**

Комисија може имати три или пет чланова.
Komisioni mund të ketë tre ose pesë anëtarë.

Оделење за Јавну службу и Друштвене делатности општине Бујановац ,кроз јавни позив за учешће на конкурсу, обавештава новинарска и медијска удружења, као и медијске стручњаке заинтересоване за рад у комисији ",да доставе предлог за чланове комисија, за сваки конкурс посебно".

Drejtorati për Shërbime publike dhe Veprimtari shoqërore pranë komunës së Bujanocit, përmes ftesës publike për pjesëmarrje në konkurs, i informon gazetarët dhe organizatat e medias, si dhe profesionistët e medias të interesuar për punën në Komision, "të paraqesë një propozim të anëtarëve të komisionit, për çdo konkurs të veçantë".

Рок за достављање предлога за чланове комисије, исти је као и рок за подношење пријава на конкурс.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve për anëtarët e komisionit, është i njëjtë si afati për dorëzimin e aplikacioneve në konkurs.

Већина чланова комисије именује се на предлог новинарских и медијских удружења уколико такав предлог постоји.

Shumica e anëtarëve të komisionit do të emërohet me propozim të gazetarëve dhe organizatat e medias, nëse një propozim i tillë ekziston.

Право на предлагање чланова имају новинарска и медијска удружења која су регистрована најмање три године пре датума расписивања конкурса.

E drejta për të propozuar anëtarë kanë shoqatat e gazetarëve dhe të mediave, që janë të regjistruar për të paktën tre vitet para datës së shpalljes së konkursit.

На основу приспелих предлога новинарских и медијских удружења за чланове комисије, руководилац органа који је расписао конкурс бира два односно три члана комисије.

Në bazë të propozimeve të arritura nga organizatat e gazetarëve dhe të mediave për anëtarë të komisionit, organi i cili ka shpallur konkursin, përzgjedh dy ose tre anëtarë të Komisionit.

Уколико је на расписани конкурс пристигло више од педесет пројектних пријава, конкурсна комисија мора имати пет чланова.

Nëse në konkursin e shpallur kanë arritur më shumë se pesëdhjetë projekt aplikime, komisioni do të ketë pesë anëtarë.

Одлука о именовању комисија објављује се на веб-сајту општине Бујановац, за сваки конкурс посебно.

Vendimi për emërimin e komisionit do të publikohen në faqen e internetit të komunës së Bujanocit, për secilin konkurs veç e veçë.

**Члан - Neni 20.**

Комисија на првој седници бира председника комисије.

Komisioni në mbledhjen e parë të tij zgjedhë kryetarin e komisonit.

Председник комисије координира рад комисије и води седнице.

Kryetari i Komisionit koordinon punën e Komisionit dhe seancat.

Оделење за Јавну службу и Друштвене делатности општине Бујановац одређује лице које ће обављати посао секретара комисије.

Drejtorati për Shërbime publike dhe Veprimtari shoqërore pranë komunës së Bujanocit, do të emërojë një person për të kryer punën e Sekretarit të Komisionit.

Секретар комисије није члан комисије.

Sekretari i Komisionit nuk është anëtar i komisionit.

Оцењивање пројекта врши сваки члан комисије независно, за сваки пројекат и по сваком од критеријума.

Vlerësimin e projektit e bën çdo anëtar i komisionit në mënyrë të pavarur për çdo projekt dhe sipas secilit kriter.

О раду комисије, води се записник.

Për punën e komisionit, mbahet procesverbali.

**Члан - Neni 21.**

Одељење за Јавну службу и Друштвене делатности општине Бујановац ради подизања квалитета информисања прибавља мишљење одговарајућег националног савета националне мањине на пријављене пројекте.

Drejtorati për Shërbime publike dhe Veprimtari shoqërore pranë komunës së Bujanocit në mënyrë që të rrisë cilësinë e informacionit do të marrë mendimin e Këshillit Kombëtar të pakicës përkatëse në projekte të regjistruara.

Мишљење националних савета националних мањина, пристигло у траженом року, доставља се, уз пројекат, члановима комисије.

Mendimi i këshillave kombëtare të pakicave kombëtare, të pranuar në afatin e caktuar, do të dorëzohet me projektin, anëtarëve të Komisionit.

Чланови комисије су у обавези да размотре мишљење националног савета националне мањине.

Anëtarët e Komisionit janë të detyruar të marrin në konsideratë mendimin e Këshillit Kombëtar të Pakicave Kombëtare.

## ОДЛУКА О РАСПОДЕЛИ СРЕДСТВА
## VENDIMI PËR NDARJEN E MJETEVE

**Члан - Neni 22.**

Одлуку о расподели средстава са образложењем на конкурсу доноси Начелник Оделења за Јавну службу и Друштвене делатности општине Бујановац, на основу предлога комисије.

Vendimi për ndarjen e mjeteve me arsyetim në konkurs e miraton Kryeshefi i Drejtoratit për Shërbime publike dhe Veprimtari shoqërore pranë komunës së Bujanocit, me propozim të Komisionit.

Предлог комисије са образложењем,потписује се од стране чланова комисије.

Propozimi i Komisionit me arsyetim, duhet të nënshkruhet nga anëtarët e komisionit.

Уколико Начелник Оделење за Јавну службу и Друштвене делатности општине Бујановац уочи да је комисија дала предлог супротно одредбама закона овог правилника и конкурса, или да садржи другу очигледну грешку, затражиће писменим путем од комисије да исправи неправилности или грешке и исправи предлог у одређеном року.

Nëse Kryeshefi i Drejtorati për Shërbime publike dhe Veprimtari shoqërore pranë komunës së Bujanocit, vëren se Komisioni ka bërë propozim në kundërshtim me dispozitat ligjore të kësaj Rregulloreje dhe konkursit, ose përmbajnë gabim tjetër të qartë, do të kërkojë me shkrim Komisionit për të korrigjuar parregullsitë ose gabimet dhe korrigjon propozimin brenda afatit të caktuar.

Одлука из става 1. овог члана, доноси се најкасније у року од 90 дана од дана закључења конкурса.

Vendimi nga paragrafi 1. të këtij neni, duhet të miratohet më së voni 90 ditë pas përfundimit të konkursit.

**Члан - Neni 23.**

Одлука о додели средстава доноси се у форми Решења.

Vendimi për të ndarjen fondeve do të bëhet në formë të Aktvendimit.

Оделење за Јавну службу и Друштвене делатности општине Бујановац доставља скенирано решење сваком учеснику конкурса у електронској форми и објављује у веб страницу општине Бујановац ( www.bujanovac.rs)

Drejtorati për Shërbime publike dhe Veprimtari shoqërore pranë komunës së Bujanocit duhet të paraqesë aktvendimin të skenuar të çdo pjesëmarrësi të konkursit në formë elektronike dhe të publikojë në web.faqe të komunës së Bujanocit (www.bujanovac.rs)

**Члан - Neni 24.**

Решење је коначно и против њега се може покренути управни спор надлежном Суду у року од 30 дана.

Vendimi është përfundimtar dhe kundër tij mund të inicohet kontest administrativ pran Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh.

**Члан - Neni 25.**

На основу решења из члана 24. овог правилника закључује се уговор, који је основ за праћење реализације суфинансираног пројекта.

Në bazë të vendimit të përmendur në nenin 24. të kësaj rregulloreje lidhet kontrata, e cila është bazë për monitorimin e zbatimit të bashkë-financuar të projektit.

Начелник Оделење за Јавну службу и Друштвене делатности општине Бујановац, учесницима конкурса којима су одобрена средства, доставља уговор у најкраћем могућем року.

Kryeshefi i Drejtorati për Shërbime publike dhe Veprimtari shoqërore pranë komunës së Bujanocit,, pjesëmarrësve të konkursit që u janë miratuar fondet, ju dorëzohet një kontratë sa më shpejt të jetë e mundur.

Учесник конкурса, коме су одобрена средства, без одлагања, доставља потписан и оверен уговор органу који је расписао конкурс.

Pjesëmarrësi i konkursit, të cilit ju është miratuar fondi, pa vonesë, të dorëzojë kontratën e nënshkruar dhe të verifikuar organit që shpalli konkursin.

Уколико учесник конкурса коме су одобрена средства не достави уговор сматраће се да је одустао од додељених средстава.

Nëse pjesëmarrësi i konkursit të cilit janë miratuar fondet nuk e dorëzon kontratën do të konsiderohen se janë tërhequr nga mjetet e ndara.

**Члан - Neni 26.**

Уговор из члана 25. овог правилника, између осталог, садржи и:

Kontrata nga nenin 25 të kësaj rregulloreje, mes tjerash, përmban:

1) спецификацију одобрених трошкова;
specifikimin e shpenzimeve të miratuara;

2) динамику реализације пројекта;
orari i zbatimit të projektit;

3) рокове за достављање наративног и финансијског извештаја;
afatet për dorëzimin e raporteve financiare dhe narrative;

4) обавезу обавештавања јавности који је орган суфинансирао пројекат;
detyrimi për të informuar opinionin se cili organ e ka bashkëfinancuar;

5) обавезу повраћаја средстава уколико сва средства нису искоришћена, односно ако пројекат није реализован.
detyrimi për t'u kthyer fondet nëse të gjitha fondet nuk janë përdorur, ose në qoftë se projekti nuk është zbatuar.

Додељена средства се исплаћује по динамици утврђеној уговором.

Mjetet do të barten sipas dinamikës së përcaktuara me kontratë.

## V. НАРАТИВНИ И ФИНАНСИЈСКИ ИЗВЕШТАЈ
## V. RAPORTI FINANCIARË DHE NARRATIV

**Члан - Neni 27.**

Учесници конкурса који су добили средства, као и лица којима су одобрена средства за појединачно давање, извештај о реализацији пројекта достављају органу који је доделио средства, у форми наративног и финансијског извештаја, а у складу са законом и закљученим уговором.

Pjesëmarrësit e konkursit të cilët kanë marrë mjetet, si dhe personave të cilëve u janë lejuar mjetet individuale, raporti mbi zbatimin e projektit të dorëzuar tek autoriteti që kanë ndarë mjetet, në formën e paraqitjes të raportit financiar dhe narrativ, në përputhje me ligjin dhe kontratën e lidhur.

Извештај мора бити потписан од стране овлашћеног лица и оверен печатом.

Raporti duhet jet i nënshkruar nga personi i autorizuar dhe vulosur.

**Члан - Neni 28.**

Ако се у току извештавања утврди да је дошло до ненаменског коришћења средстава или корисник средстава не достави извештај о коришћењу средстава, односно достави непотпун и неправилан извештај надлежни орган ће тражити да се у року од 8 дана изврши допуна или исправка извештаја.

Nëse gjatë raportimit konstatohet se ka ardhur deri te shfrytëzimi i mjeteve jashtë destinimit ose se shfrytëzuesi i mjeteve nuk paraqet raportin mbi shfrytëzimin e mjeteve, përkatësisht paraqet raport jo të plotë dhe jo të rregullt, organi kompetent do të kërkoj që plotësimi ose përmirësimi i raportit të bëhet në afat prej 8 ditësh.

Ако корисник не поступи по налогу из става 1. овог члана, дужан да одобрени исплаћени износ врати са каматом по стопи утврђеној законом.

Nëse shfrytëzuesi nuk vepron sipas urdhërit nga paragrafi 1. i këtij neni, është i obliguar ta kthej shumën e mjeteve të paguara me gjithë kamatën sipas normës së përcaktuar me ligj.

**Члан - Neni 29.**

Све што није предвиђено овим правилником, примењиват ће се Закон о јавном информисању и медијама.

Çdo gjë që nuk është paraparë me këtë rregullore,do të zbatohet Ligji për informim publik dhe mediave.

**Члан - Neni 30.**

Ступањем на снагу овог Правилника, престаје да важи Правилник о условима и начину коришћења средстава за јавно информисање од локалног значаја бр. 06-4/15-03 од 12.02.2015 године.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja mbi kushtet dhe mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve për informim publik të rëndësisë lokale me nr. 06-4/15-03 të datës 12.02.2015.

**Члан - Neni 31.**

Овај Правилник ступа на снагу након објављивања у “Службени гласник општине Бујановац”.

Kjo Rregullore hynë në fuqi në ditën e publikimit në “Gazetën zyrtare të Komunës së Bujanocit”.

**ОПШТИНА БУЈАНОВАЦ – ОПШТИНСКО ВЕЋЕ**
**KOMUNA E BUJANOCIT – KËSHILLI KOMUNAL**

**Број - Numër: 02-24/15-03**
**Саставио - Hartoi,**
**Нач. Одел. за Јавне сл. и друш. дел.**
**Kry. i Drejt. për shër. pub. dhe vepr. shoq.**
**Bajram Fejzullahu**

**ПРЕДСЕДНИК - KRYETAR**
**Nagip Arifi, с.п-d.v.**

**53**

На основу члана 11. Закона о ученичком и студентском стандарду ("Сл. гласник РС" бр. 18/2010 и 55/2013), члана 44. Закона о локалној самоуправи ("Сл. гласник РС" бр. 129/2007) и члана 14. став 42. Статута општине Бујановац ("Сл. Гласник пчињског округа" бр. 24/08), Општинско веће општине Бујановац, на седници одржаној дана **11.03. 2015**. године, донело је

Në bazë të nenit 11. Të Ligjit mbi standardin e nxënësve dhe të studentëve (“Gazeta zyrtare e RS” nr. 18/2010 dhe 55/2013), të nenit 44. Të Ligjit mbi vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RS” nr. 129/2007) dhe të nenit 14 paragrafi 42 të Statutit të Komunës së Bujanocit (“Gazeta zyrtare e rrethit të Pçinjës” nr. 24/08) Këshilli komunal i komunës së Bujanocit në seancën e mbajtur më **11.03.2015** bie

## ПРАВИЛНИК О СТИПЕНДИРАЊУ СТУДЕНАТА СА ТЕРИТОРИЈЕ ОПШТИНЕ БУЈАНОВАЦ
## RREGULLORE MBI NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENT NGA TERRITORI I KOMUNËS SË BUJANOCIT

### I ОПШТЕ ОДРЕДБЕ
### I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

**Члан - Neni 1.**

Овим Правилником о додели стипендија (у даљем тексту: Правилник) уређује се начин, поступак, висина и услови давања стипендија за студенте са територије Општине Бујановац.

Me këtë Rregullore mbi ndarjen e bursave (në vazhdim të tekstit: Rregullore) rregullohet mënyra, procedura, lartësia dhe kushtet e dhënies së bursave studentëve të Komunës së Bujanocit.

**Члан - Neni 2.**

Корисници стипендије су студенти под условом да:

- имају пребивалиште на територији општине Бујановац,
- су редовни студенти основних и мастер студија на факултетима или вишим школама на територији Србије или у иностранству,
- студирају на факултетима или вишим школама акредитованих од стране Министарства просвете, науке и технолошког развоја Републике Србије, а ако студирају у иностранству на међународно признатим факултетима или вишим школама чије дипломе се могу нострификовати на факултетима или вишим школама у Републици Србији.

Shfrytëzues të bursës janë studentët që plotësojnë këto kushte:

- të kenë vendbanimin në territorin e Komunës së Bujanocit,
- të jenë student të rregullt të studimeve themelore dhe master në fakultetet apo shkollat e larta në territorin e Serbisë ose jashtë saj,
